1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;

- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Klasifikimi i Riparimeve:

- 1) Riparime profilaktike (pjesët e ndërrimit që zëvendësohen me kohë përdorimi),
- 2) Riparime difektesh (zëvendësim pjesë ndërrimi të konsumuara),
- 3) Riparime të përgjithshme (kthimi i agregatit në parametrat fillestar).

I. Të dhëna teknike për Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit:

- a) duhet të jenë të reja;
- b) të jenë prodhime origjinale nga prodhuesi i mjetit ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi i mjetit;
- c) Vaji i motorrit të jetë i certifikuar sipas standarteve ndërkombëtare ACEA, API ose standardeve kombëtare / ndërkombëtare ekuivalente me to.
- d) Vaji i kutisë së shpejtësisë, ridotos, diferencialit dhe vaji hidraulik të jenë certifikuar sipas standarteve ACEA, API ose standardeve kombëtare / ndërkombëtare ekuivalente me to.

II. Afati i garancisë së Aggregateve / Pajisjeve / Pjesëve të këmbimit:

Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit duhet të ofrohen sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi i automjetit ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi i automjetit.

III. Afatet e kryerjes së shërbimit:

- Riparim profilaktik (ndërrim filtra dhe vaji i motorrit), jo me shumë se katër orë,
- Riparim profilaktik (rrip faze/zinxhir motori) kit, jo më shumë se tetë orë,
- Riparime xhenerike (brenda një sistemi), jo më shumë se tetë orë,
- Riparime xhenerike (me shume se një sistem) jo më shumë se gjashtëmbdhjetë orë,
- Diagnostikim dhe riparime elektrike jo më shumë se katër orë,
- Riparime kapital, agregat motori, jo më shumë se 120 orë,
- Riparime në motor (guarnicion testate, ndrrim fasho motorri) jo më shumë 24 orë,
- Riparim kuti shpejtësie jo më shumë se 16 orë,
- Riparim diferenciali jo më shumë se 16 orë,
- Riparime të dëmtimit të karrocerisë (i lehtë), jo më shumë se 24 orë,
- Riparime të dëmtimit të karrocerisë (i mesëm), jo më shumë se 48 orë,
- Riparime të dëmtimit të karrocerisë (i rëndë), jo më shumë se 120 orë,

IV. Normativat e ndërrimit të pjesëve profilaktike:

- Filtrat e motorrit, sipas përcaktimit të rekomanduar nga prodhuesi i automjetit, evidentuar në katalogun e mirëmbajtjes,
- Vaji i motorrit, sipas përcaktimit të rekomanduar nga prodhuesi i automjetit, evidentuar në katalogun e mirëmbajtjes,
- Rrapi i fazës/ zinxhiri, sipas përcaktimit të rekomanduar nga prodhuesi i automjetit, evidentuar në katalogun e mirëmbajtjes.

V. Shërbimi që kërkohet:

- 1) Riparimet / mirëmbajtja e mjeteve nga ana e Operatorit Ekonomik, do të kryhet sipas kërkesave teknike dhe në përputhje të plotë me normat dhe standartet e miratuara për këtë qëllim.
- 2) Riparimet / mirëmbajtja e mjeteve pranë Operatorit Ekonomik, do të kryhet në mënyrë periodike, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- 3) Operatori Ekonomik ka detyrimin e kryerjes pa pagesë të shërbimeve të riparimit / mirëmbajtjes që rezultojnë jo sipas kushteve teknike dhe afateve të garancisë, të përcaktuara në termat e referencës dhe specifikimet teknike, sipas afateve të kryerjes së shërbimit.
- 4) Operatori Ekonomik ka detyrimin e kryerjes së transportit të mjeteve, të cilat janë të difektuara dhe nuk kanë mundësi për vetëlëvizje, nga vend bllokimi i tyre deri në servis, nëpërmjet shërbimit me karrotrec dhe pa pagesë shtesë.

VI. Detyrat në lidhje me shërbimin:

- mjeti paraqitet në servis, nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor, ku mbasi i është kryer procesi i larjes, sipas pretendimit të drejtuesit të mjetit, i nënshtrohet kontrollit teknik nga ana e specialistëve të Operatorit Ekonomik.
- në prezencë të përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, Operatori Ekonomik mbasi ka kryer testimin e difektimit të mjetit, në paisjet përkatëse, evidenton difektet e mundëshme dhe përpilon preventivin teknik, ku një kopje ja delegon Autoritetit Kontraktor.
- pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor, të preventivit të përgatitur, në zëra difektimi dhe shoqëruar me pjesë këmbimi dhe volumen e punimeve që do të kryhen, Operatori ekonomik bënë regjistrimin e mjetit në libër, ku evidenton emrin e drejtuesit të mjetit, marka e mjetit, targa, numri i shasisë, evidentimi i difekteve dhe kohën e rregjistrimit.
- me përfundimin e regjistrimit, në librin përkatës, nis procesi i riparimit, i cili duhet të përfundojë brënda afateve kohore të dakortësuara. Gjatë procesit të riparimit përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Operatori Ekonomik kryen verifikimet e nevojshme në riparimet e kryera, pjesët e ndërrimit të zëvendësuara dhe kohën e harxhuar.

-
- me përfundimin e riparimit të mjetit, personi përgjegjës, i autorizuar pranë servisit, njofton Autoritetin Kontraktor, për përfundimin e riparimit të mjetit, në mënyrë që të bëhet tërheqja e mjetit pranë servisit.
 - përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor paraqitet pranë servisit dhe bën verifikimin e shërbimit të kryer dhe pjesët e ndërrimit të zëvendësuara, sipas preventivit të miratuar. Nëse të dy palët janë dakortësuar, mbi volumin e punimeve të kryera, hartohet procesverbal i përbashket, në tre kopje, në prani të përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, drejtuesit të mjetit si dhe Operatorit Ekonomik.
 - pas kontrollit të mjetit, në paisjet kontrolluese, dhe firmosjes së procesverbalit drejtuesi i mjetit tërheq automjetin nga servisi.
 - procesi përfundimtar i riparimit të mjetit, krahas procesverbalit, shoqërohet me faturën tatimore dhe aktin e garancisë së riparimit.
 - pjesët e ndërrimit të zëvendësuara, në mjet, i dorëzohen, me procesverbal të veçantë, drejtuesit të mjetit, i cili duhet t'i bëjë hyrje në magazinë e Autoritetit Kontraktor, për veprime të mëtejshme.

Autoriteti Kontraktor në bashkëveprim me Operatorin Ekonomik, nëpërmjet një Proces Verbal të mbajtur nga një komision specialistësh, të vlersojnë të gjitha dëmtimet pasojë e keqshfrytëzimit të mjetit dhe pas nxjerrjes së përgjegjësisë individuale të fillojë proçeduar e eliminimit të difekteve. Proçes Verbal do të bashkëlidhet situacionit të punimeve.

Operatori ekonomik duhet të disponojë listimin e kohës së riparimit për çdo difektim të ndodhur në automjet.

Afatet e ekzekutimit: Nga lidhja e Kontratës deri më 31.12.2025.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen: “Riparimi dhe mirembajtja e mjeteve te Drejtorise se Pergjithshme te Rezervave Materiale te Shtetit”

Afatet e ekzekutimit: Nga lidhja e kontrates deri me 31.12.2025

Fuoristradë MERCEDES-BENZ ME TARGA AA486YG NAFTE VITI 2010 Automatike, FUQI MOTORIKE 2987cc GOMA 255/50R19 (VENDNDODHJE TIRANE)				
Shërbimet	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim Vendorsje Filtër ajri	copë	1	
2	Furnizim Vendorsje Filtër vaji	copë	1	
3	Furnizim Vendorsje Filtër kondicioneri	copë	1	
4	Furnizim Vendorsje Filtër naftë	copë	1	
5	Zevendesim Vaj motorri 5W30	litra	10	
6	Furnizim Vendorsje Tubi i thithjes së ajrit tek filtri i ajrit	copë	1	
7	Furnizim Vendorsje Gomina qendrore e stabilizatorit	copë	2	
8	Furnizim Vendorsje Gominat e serbentinës	copë	1	
9	Furnizim Vendorsje Bazamenti i filtrit të vajit	copë	1	
10	Furnizim vendorsje pasqyre krahu djathtë	copë	1	

11	Ndërrim i xhamit të parë (Ballor)	copë	1	
12	Furnizim Vendorsje Kandeleta	copë	4	
13	Furnizim vendorsje Antifrizë	litra	4	
14	Riparim Lyerje parakolpi	copë	1	
15	Riparim Lyerje prapakolpi	copë	1	
16	Furnizim Vendorsje Llama fenerësh	copë	2	
17	Furnizim Vendorsje Kit zinxhir motorri	copë	1	
18	Furnizim Vendorsje Permistop mrapaolio me skatull	copë	1	
19	Furnizim Vendorsje Permistop kollodoku	copë	1	
20	Furnizim Vendorsje Bilancier boshti	copë	24	
21	Furnizim Vendorsje Punturi valvulash	copë	24	
22	Furnizim Vendorsje Rondele injektori	copë	6	
23	Furnizim Vendorsje Gomina injatorësh	copë	6	
24	Furnizim Vendorsje Guarnicion pompe vakumi	copë	1	
25	Furnizim Vendorsje Gomine farfalle	copë	1	
26	Furnizim Vendorsje Zinxhir pompe vaji	copë	1	
27	Furnizim Vendorsje Guarnicion pompe	copë	1	
28	Plotesim Vaj hidrauliku	litra	1	
VOLKSWAGEN TIGUAN ME TARGA AB618LR NAFTE VITI 2011 MANUAL Nr. Shasie WVGZZZ5NZBW072554 FUQIA 1968 (VENDNDODHJE TIRANE)				
Shërbimet	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim vendorsje Vaj motorri 5w30	litra	5	

2	Furnizim Vendorsje Filtër ajri	copë	1	
3	Furnizim Vendorsje Filtër vaji	copë	1	
4	Furnizim Vendorsje Filtër nafte	copë	1	
5	Furnizim Vendorsje Filtër kondicioneri	copë	1	
6	Furnizim Vendorsje Gomina shpatulle	copë	4	
7	Ndërrim i EGR	copë	1	
8	Riparimambio (rrjedhje)	copë	1	
9	Furnizim Vendorsje Ferrota para	set	1	
10	Furnizim Vendorsje Ferrota mbrapa	set	1	
11	Furnizim Vendorsje Tambure para	copë	2	
12	Furnizim Vendorsje Tambure mbrapa	copë	2	
13	Furnizim vendorsje Antifrizë	litra	1	

Autoveture SKODA YETI ME TARGA AA496BO SHASI: TMBJF45L4C6021349
Benzine VITI 2011 Automatike (VENDNDODHJE Tirane)

Shërbimet	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim Vendorsje Filtër ajri	copë	1	
2	Furnizim Vendorsje Filtër vaji	copë	1	
3	Furnizim Vendorsje Filtri i benzinës	copë	1	
4	Furnizim vendorsje Vaj motorri 5w30	litra	4	
5	Riparim i bravës së bagazhit	copë	1	
6	Furnizim Vendorsje Bateri 72 A	copë	1	

7	Furnizim vendosje Antifrizë	litra	4	
AUTOVETURE AUDI A4 ME TARGA AB724PF VITI 2001 NAFTE FUQIA MOTORIKE 1900cc MANUALE Gomat 205.55.R16 (VEND NDODHJA PUKE)				
Shërbimet	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim Vendosje Filtër ajri	copë	1	
2	Furnizim Vendosje Filtër kondicioneri	copë	1	
3	Furnizim Vendosje Filtër vaji	copë	1	
4	Furnizim Vendosje Filtër naftë	copë	1	
5	Furnizim vendosje Vaj motorri 10w40	litra	5	
AUTOVETURE OPEL ASTRA ME TARGA MM404MM NAFTE, Viti 2005 (VENDNDODHJE KORCE)				
Shërbimet	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim Vendosje Filtër ajri	copë	1	
2	Furnizim Vendosje Filtër vaji	copë	1	
3	Furnizim Vendosje Filtër naftë	copë	1	
4	Furnizim vendosje Vaj motorri 10w40	litra	6	
5	Furnizim vendosje Alkool frenash	litra	4	
6	Furnizim Vendosje Volant + kuzhinete (kit)	copë	1	
7	Furnizim Vendosj Gominë shpatulle e madhe	copë	1	
8	Furnizim vendosje Vaj kambio(kutise se shpejtesise)	litra	3	
Autoveture VOLKSWAGEN PASSAT ME TARGA AA174KU VITI 2004 , MANUALE, NAFTE, FUQIA 1986 SHASI WVVZZZ3BZ5E104223 (VENDNDODHJE MAT)				

Shërbimet	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim Vendorsje Filtër ajri	copë	1	
2	Furnizim Vendorsje Filtër vaji	copë	1	
3	Furnizim Vendorsje Filtër naftë	copë	1	
4	Furnizim vendorsje Vaj motorri 10w40	litra	7	
5	Furnizim Vendorsje Rrip faze	copë	1	
6	Furnizim vendorsje Antifrizë	litra	4	
7	Furnizim Vendorsje Fshirëse xhami para	set	1	
Kamioncine MERCEDES-BENZ ME TARGA AA548AR, VITI 1995 Manuale FUQI 4000 Gomat 215.75.R.17.5 (VENDNDODHJA TIRANE)				
Shërbimet	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim Vendorsje Filtër ajri	copë	1	
2	Furnizim Vendorsje Filtër vaji	copë	1	
3	Furnizim Vendorsje Filtër naftë	copë	1	
4	Vaj motorri 10w40	litra	10	
5	Goma 215/75 R17.5	copë	6	
6	Furnizim Vendorsje Kuzhinetë centrale	copë	1	
7	Furnizim vendorsje Bateri 150 A	copë	2	
AUTOVETURE SEAT ALHAMBRA SHASI: VSSZZZ7MZ1V510031 NAFTE MANUALE FUQIA 1900 VITI 2000 (VENDNDODHJA TIRANE)				

Shërbimet	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim Vendorsje Filtër ajri	copë	1	
2	Furnizim Vendorsje Filtër vaji	copë	1	
3	Furnizim Vendorsje Filtër nafte	copë	1	
4	Furnizim vendorsje Vaj motorri 5w30	litra	7	
5	Furnizim Vendorsje Pompë uji	copë	1	
6	Furnizim Vendorsje Rrip dinamo	copë	1	
7	Furnizim Vendorsje Pulexho dinamo me freksion	copë	1	

KAMION VOLVO F12 SHASI: YV2A4B2A9SB124307, NAFTE VITI 2004
MANUALE (VENDNDODHJA TIRANE)

Shërbimet	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim Vendorsje Pompë uji	copë	1	
2	Furnizim Vendorsje Këmisha motorri	copë	6	
3	Furnizim Vendorsje Bronzina	copë	6	
4	Furnizim Vendorsje Reinzi sipërm	set	1	
5	Furnizim Vendorsje Bronzina bjelle	copë	6	
6	Furnizim Vendorsje Fasho piston	copë	6	
7	Furnizim vendorsje Vaj 15w40	litra	38	
8	Furnizim Vendorsje Sofjeta para	copë	2	
9	Furnizim Vendorsje Jastikë ajri	copë	3	

10	Furnizim vendosje Vaj kambio(kutise se shpejtesise)	litra	20	
11	Furnizim Vendosje Gomina e pistonit të kabinës	kit	1	
12	Furnizim Vendosje Gomina stabilizatori	cop	2	
13	Furnizim Vendosje Vaj Diferenciali	litra	15	
14	Furnizim Vendosje Filtër vaji	copë	3	
15	Furnizim Vendosje Filtër nafte	copë	1	
16	Furnizim Vendosje Filtër ajri	copë	1	
17	Furnizim Vendosje Filtër kompresori	copë	1	

Pirun TAILIFT, NAFTE, 2016 (VENDNDODHJE TIRANE)

Shërbimet	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim Vendosje Filtër ajri	copë	1	
2	Furnizim Vendosje Filtër i vajit të motorit	copë	1	
3	Furnizim Vendosje Filtër nafte	copë	1	
4	Furnizim vendosje Vaj motorin 5w40	litra	9	
5	Furnizim vendosje Bateri 100 A	copë	1	

KOKË TRAJLERI ME NR. SHASIE XLRTE47MS0E837448 DHE PLATFORMË ME NR SHASIE WSMS6980000524175 (VENDNDODHJA TIRANE)

Shërbimet	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim vendosje Bateri 180 A	copë	2	
2	Furnizim vendosje Vaj motorri 15 w40	litra	40	

3	Furnizim Vendorsje Ferrota	akse	5	
4	Furnizim Vendorsje Jastikë ajri	copë	6	
5	Riparim linje sistemi elektrik	copë	1	
6	Riparim tubash nga sebratori madh tek i vogli	copë	1	
7	Furnizim Vendorsje Sofjeta frenash	copë	4	
8	Riparim i Ad blu	copë	1	
9	Furnizim Vendorsje Filter ajri	copë	2	
10	Furnizim Vendorsje Filtra nafte	copë	1	
11	Riparim i portave mbrapa	copë	2	
12	Furnizim Vendorsje i mbulesës së sipërme të platformës	copë	1	
13	Furnizim Vendorsje Goma 315.70.R22.5	copë	2	
14	Furnizim Vendorsje Goma 385.65.R22.5	copë	4	

AUTOVETURE SKODA YETI SHASIA: TMBJF45L2C6020586 BENZINE, VITI 2011, AUTOMATIKE, FUQIA 1.2 GOMA 215/60R16 (VENDNDODHJE TIRANE)

Shërbimet	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim Vendorsje Termostat	copë	1	
2	Furnizim Vendorsje Tub uji	copë	1	
3	Furnizim Vendorsje Filtër ajri	copë	1	
4	Furnizim Vendorsje Filtër vaji	copë	1	
5	Furnizim Vendorsje Filtër benzine	copë	1	
6	Furnizim Vendorsje Filtër kondicioneri	copë	1	

7	Furnizim vendosje Vaj motorri 5w30	litra	4	
8	Furnizim vendosje Antifrizë	litra	5	
9	Furnizim vendosje Goma 215/60 R16	copë	4	
10	Riparim Konvergjencë	copë	1	
11	Furnizim Vendosje Filmi i timonit+ Boria	copë	1	
12	Furnizim Vendosje Ferrota para	set	1	
13	Furnizim Vendosje Ferrota mbrapa	set	1	
AUTOVETURE BMW ME NR. SHASIE WBAHN83586DT62635 Benzine Viti 2006, Automatike GOMAT 245.40.R19 (Vendodhje Tirane)				
Shërbimet	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim vendosje Vaj motorri 10w40	litra	9	
2	Furnizim vendosje Bateri 100A	copë	1	
3	Furnizim Vendosje Pompë benzine	copë	1	
4	Furnizim Vendosje Filtër ajri	copë	1	
5	Furnizim Vendosje Filtër benzine	copë	1	
6	Furnizim Vendosje Filtër vaji	copë	1	
7	Furnizim Vendosje Filtër kondicioneri	copë	1	
8	Furnizim Vendosje Amortizator kofanoje	set	1	
9	Furnizim Vendosje Amortizator bagazhi	set	1	
10	Furnizim Vendosje Pompë frenash	copë	1	
11	Furnizim Vendosje Filtra gazi	copë	2	

12	Furnizim vendosjen Antifrize	litra	5	
13	Furnizim Vendosje Fshirëse xhami	set	1	
14	Furnizim Vendosje Këmbë motorri	copë	2	
15	Furnizim Vendosje Këmbë kambio	copë	1	
16	Furnizim Vendosje Ferrota para	set	1	
17	Furnizim Vendosje Ferrota mbrapa	set	1	
18	Furnizim Vendosje Tambure para	copë	2	
19	Furnizim Vendosje Tambure mbrapa	copë	2	
20	Riparim i Celësit te hapjes dhe mbylljes se mjetit	copë	1	
21	Furnizim Vendosje Gominat e shpatullës	copë	2	
22	Furnizim vendosje Vaj kambio(kutise se shpejtesise)	litra	5	
23	Riparim kambio	copë	1	
24	Furnizim Vendosje Goma 245.40.R19	copë	4	

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **Riparimi dhe mirembajtja e mjeteve te Drejtorise se Pergjithshme te Rezervave Mataeriale te Shtetit**

I. Përkufizime

1. “**Autoriparim**” është **riparimi dhe mirëmbajtja** e mjeteve me motor dhe e rimorkiove, të destinuara për transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave, **me përjashtim të** shërbimeve të larjes, të fryrjes së gomave, të furnizimit me karburant, zëvendësimit të filtrit të ajrit dhe të vajit, të lëndës djegëse dhe të lubrifikantëve, të lëngjeve punuese hidraulike dhe të lëngjeve ftohëse.
2. “**Veprimtari të riparimit**” janë të gjitha operacionet për zëvendësimin dhe modifikimin e çdo komponenti të mjeteve me motor dhe rimorkiove, si dhe instalimin e impianteve e të komponenteve fikse në një mjet të vetëm ose në një kompleks mjetes me motor.
3. “**Veprimtari e mirëmbajtjes së mjeteve me motor dhe të rimorkiove**” është mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të karrocërisë, të impiantit elektrik dhe të gomave.
4. “**Agregat**”: përbëhet nga shumë pjesë këmbimi të ndryshme të lidhura në çiftëzime, të lëvizëshme dhe të palëvizëshme për të kryer një proces pune të caktuar e cila ka një vlerë monetare relativisht të lartë (p.sh. agregati i motorit, kutia e shpejtësisë, ridoto, diferencial).
5. “**Paijsja**”: përbëhet nga disa pjesë këmbimi të çiftëzuara, që kryen një punë të caktuar dhe ka një vlerë relativisht mesatare (p.sh. pompa të ndryshme, motorino, alternator, amortizator transmesion etj).
6. “**Pjesë këmbimi**”: përbëhet nga një ose më shumë detale dhe kryen një funksion të caktuar dhe ka një vlerë relativisht të ulët (p.sh. koka paraleli, koka avantreni, krah të ndryshëm, ferrota freni, ingranazhe, kushineta, premistop, gomina etj).

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në autoservisin e Operatorit Ekonomik fitues për llogari të autoritetit kontraktor **Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit**

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

-
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe te motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara..
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 6 (gjashtë) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti.
- b) 1 (një) motorrist
- c) 1 (një) xhenerik

-
- d) 1 (një) pompist
 - e) 1 (një) elektroauto
 - f) 1 (një) bojaxhi- llamarinist

Në lidhje me punonjësin në pikën (a), duhet të paraqitet:

- diploma e arsimit të lartë dhe/ose dëshmia e aftësisë profesionale

- kontratë pune (të vlefshme) si përgjegjës Teknik, dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.

Për secilin prej punonjësve në pikat (b, c, d, e, f) më sipër duhet të paraqitet:

- kontratat e punës, e vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, pompist, elektroauto dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.
- Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar.

Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohej sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata, e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergences) së rrotave të mjetit
- b) pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo);
- c) pajisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete;
- d) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit.
- e) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të amortizimit të automjetit.
- f) pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v;
- g) pajisje urë ngritese për automjetet, të paktën 2 (dy) ura ngritese për mjetet objekt prokurimi
- h) pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;
- i) pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit;
- j) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.
- k) pajisje për saldime me oksigjen & argon & saldime elektrik
- l) te kete repart te riparimit te karrocise se automjetit (Shasise dhe perpunimit te llamarines) si dhe bojatisjes se mjetit te pajisur me: furre per lyerje, repartin per pergatitjen paraprake per bojatisje te kompletuar me pajisjet perkatese, si edhe pajisje per drejtim shasie te cilat te kene kapacitet ne pershtatje te plote per realizimin e sherbimeve te mjeteve.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- Dokumenta që vërtetojnë se këto pajisje i ka aktualisht në pronësi ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) karrotrec, për transportimin e automjeteve të difektuara.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

- Leja e qarkullimit të mjetit, Akt – kolaudimi, Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet, Foto të mjeteve ku të duket qartë targa dhe sinjalistika përkatëse.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Agregatat / Pajisjet / Pjesët e këmbimit që do të ofrohen do të jenë të reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument provues për dorëzimin e vajrave të përdorura te subjekti që është pajisur me leje për transportimin, rikuperimin dhe/ose asgjësimin e VP-ve në përmbushje të VKM 765 datë 07.11.2012 Per miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorur.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve përkatësisht:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

- ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

- ISO 45001 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqiten:

Çertifikatat përkatëse, objekti i së cilave duhet të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jenë brenda afatit të vlefshmërisë të paktën në datën e hapjes së ofertave.

